



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 12/03/2013  
Nr. 0204-206

**PËR: Shaip Surdulli, Kryetar i Komunës së Kamenicës**  
**Enver Mavriqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës**

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS NR.1/887 pranuar me datën 26.02.2013**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.01/887 të miratuar me datën 31.01.2013 nga Kuvendi i Komunës së Kamneicës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr.01/887 për ndarjen e mjeteve për dhënien e bursave për Studentet e vitit Akademik 2012-2013.

Me respekt,

Slobodan Petrović,  
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL,

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum, 12/03/2013  
Br. 0204-206

**Za: Shaip Surdulli, Gradonačelnik Opštine Kamenica**  
**Enver Mavriqi, Predsjedavajući Skupštine Opštine Kamenica**

**Predmet: Potvrda Zakonitosti Odluke Opštine Kamenica Br.1/887 primljeno dana 26.02.2013**

Poštovani , e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br.01/887 odobreno dana 31.01.2013 od strane Skupštine opštine Kamenica, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi

Odluka Br.1/887 o dodeli sredstava za stipendije za Studente Akademske godine 2012-2013.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*  
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*  
*Arhivi MALS-a.*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

HYRË E KLASIFIKIMIT  
EDUCATIONAL RESOURCES REPOSITORY  
GENERALNA I KOSOVES Vlada PUSLOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data  
Datum 26.02.2013  
Date

Tipi i organizatës	nr. i lëndës	Shënime	Vlera
- 1 -	007-26	7	

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



KUVENDI I KOMUNËS  
KRYESUESI I KUVENDIT  
01.nr. \_\_\_\_\_, më 30.01.2013

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANS

Sh. Nr. 21 Nr. 557  
D. Nr. 1 Data 01/02  
Op. Nr. KAMENICJA 2013

Në bazë të nenit 24,24.1,24.2,24.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr./031-040) dhe nenit 46 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2013, duke shqyrtuar pikën 4 të rendit të ditës, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**MBI NDARJEN E MJETEVE PËR BURSA STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2012/2013**

**I**

Lejohet vazhdimi i kompensimit të mjeteve për bursa studentëve shfrytëzues nga viti akademik 2011/2012 të cilët i kanë plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs dhe ndahen mjete financiare për 50 bursistë të rinj për vitin akademik 2012/2013. Lartësia mujore e bursës është 50 € në muaj dhe studentët e shfrytëzojnë për periudhën kohore 01.09.2012 deri më 30.06.2013.

**II**

Drejtoria e Arsimit ka parashtruar Kërkesën nr.12 më 16.01.2013 dhe ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës miratimin e vendimit për vazhdimin e dhënies së bursave për studentët shfrytëzues dhe ndarjen e bursave të reja studentore për vitin akademik 2012/2013.

**III**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2013 e ka shqyrtuar kërkesën dhe e ka miratuar duke vendosur që t'iu vazhdohet kompensimi i bursave studentëve shfrytëzues nga viti i kaluar të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe të sigurohen mjete për ndarjen e 50 bursave të reja për vitin akademik 2012./2013. Njëherit ka autorizuar kryetarin dhe zyrtarin lartë financiar që të sigurojnë mjetet financiare dhe ti bartin në kodin adekuat.

Përzgjedhja e studentëve përfitues të bursave bëhet në bazë të konkursit të shpallur nga Drejtoria e Arsimit.

**IV**

Implementimin e Vendimit e bën Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Arsimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset kryetari.

**V**

Me Vendimin të njoftohen: Kryetari, Kryesuesi, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Shërbimi Profesional i Kuvendit, Zyra Ligjore, Zyra e Përkthimeve dhe Qendra për Shërbime të Qytetarëve.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Enver Mavriqi